



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi
VENDIM

Nr.197, datë 12.12.2019

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË OSHEE SH.A PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 167,
DATË 04.11.2019 "MBI MIRATIMIN E DRAFT
KONTRATËS PËR SHIT-BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET
SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE KESH SH.A.,
AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA
SHTETI DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL/OSHEE SH.A, PËR
FURNIZIMIN E KLIENTËVE FUNDORË PËR PERIUdhËN KOHORE 01.01.2019 -
31.12.2019"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 16 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2018 mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “OSHEE“ sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Çështjeve Ligjore, me nr. 114/6 Prot, datë 10.12.2019, mbi kërkesën për rishikimin e vendimit të bordit të ERE nr. 167 datë, 04.11.2019, “Mbi miratimin e draft kontratës për shit-bletjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a, për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 01.01.2019 - 31.12.2019”,

Konstatoi se:

- Me vendim nr. 167, Datë 04.11.2019, bordi i ERE është shprehur për miratimin e draft kontratës për shit-bletjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/ OSHEE sh.a, për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019.
- Shoqëria OSHEE sh.a. me shkresën nr. 8020/3/1 datë 14.11.2019 protokolluar në ERE me nr.716/1 prot dhe datë 15.11.2019 i është drejtuar ERE më kërkesën për rishikimin e vendimit të bordit të ERE nr. 167, date 04.11.2019 "Mbi miratimin e draft kontratës për shit-bletjen e energjise elektrike ndërmjet shoqerise së prodhimit të energjisë elektrike KESH sh.a, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe

furnizuesit të shërbimit universal/ OSHEE sh.a, për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 01.01.2019 -31.12.2019"

- Neni 16 i Rregullores së organizimit funksionimit dhe procedurave të ERE, parashikon se: *Për një Vendim të Bordit, çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.*
- Në lidhje me plotësimin e kushtit për depozitimin e kërkesës brenda afatit të parashikuar në rregullore rezulton se, OSHEE sh.a. ka ankimuar vendimin e sipërcituar brenda afateve të parashikuara në rregullore.
- Sa i përket provave të reja, të tilla që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, spjegojmë në vijim duke analizuar pikë për pikë pretendimet e palës ankimuese.
- Më poshtë po parashtrajmë pretendimet e OSHEE sh.a për të legjitimuar kërkesën për rishikim:
 1. *Palët kanë parashikuar që kjo kontratë do të shtrinte efektet e saj nga momenti i dakortësimit të draftit e në vijim, pra për periudhën kohore 01.03.2019-31.12.2019, pasi nuk mund të pretendonin vlerësimin e marrëdhënies së tyre kontraktore për pasojat tashmë të ardhura me parashikimet e reja të dakortësuara, në kushtet kur kishte në fuqi një kontratë e miratuar me vendim të ERE që rregullonte marrëdhëniet midis tyre dhe palët ndërkohë kanë ngritur pretendime ndaj njëra tjetrës në respektim të kontratës në fuqi.*
 2. *Neni 3, pika 7 "vlera e kompesimit" është parashikuar nga palët në kontratë: "vlera që rezulton për sasinë e energjisë së paplotësuar nga shitësi me çmimin mesatar të shitjes së energjisë po nga ana e shitësit në tregun e parregulluar", parashikim ky sipas përcaktimeve të VKM Nr.244/20 16 i ndryshuar, ku parashikohet se vlera e kompesimit do të bëhet sipas kontratës.*
 3. *Neni 9 pika 1, është propozuar me vullnet të palëve dhe ka pasur për qëllim kompesimin e blerësit për sasinë e paplotësuar nga pala shitëse me çmimin mesatar të shitjes së energjisë nga ana e shitësit në tregun e parregulluar, me qëllim kompensimin e blerësit sa me afër vlerës së shpenzuar për sigurimin e energjisë elektrike në treg të parregulluar. Dhe pse ky propozim ka gjetur mbështetjen dhe vullnetin e palëve kontraktore nuk është pranuar nga ana e ERE.*
 4. *Në lidhje me parashikimin e Nenit 9, pika 1/1, ERE duhet të sqarojë faktin se si do të vlerësohen të ardhurat e nevojshme që duhet të depozitohet pala shitëse në llogarinë "escrow" me qëllim përmbushjen e detyrimeve për kompensimin e sasisë së paplotësuar ndaj blerësit.*
 5. *Në lidhje me parashikimin e nenit 9, pika 1.3 të kontratës së miratuar nga ERE, shoqëria OSHEE sh.a kërkon nga ana e ERE të respektojë propozimin dhe vullnetin e palëve për pranimin e kompesimit të blerësit për sasinë e paplotësuar nga pala*

shitëse me cmimin mesatar të shitjes së energjisë nga ana e shitësit në tregun e parregulluar.

6. *Në lidhje me parashikimin e nenit 11, pika 1 dhe 2 të kontratës së miratuar nga ERE ashtu sikurse kemi sqaruar dhe më sipër palët kanë përcaktuar se kjo kontratë do të shtrinte efektet e saj nga momenti i dakortësimit të draftit e në vijim, pra për periudhën kohore 01.03.2019-31.12.2019, pasi nuk mund të pretendonin vlerësimin e marrëdhënies së tyre kontraktore për pasoja tashmë të ardhura me parashikimet e reja të dakortësuara, në kushtet kur kishte në fuqi një kontratë të miratuar me vendim të ERE që rregullonte marrëdhëniet midis tyre dhe palët ndërkohë kanë ngritur pretendime ndaj njera tjetrës në respektim të kontratës në fuqi. parashikimet e mësipërme dhe me parashikimin e vendosur në kontratën e miratuar me vendimin nr. 167/2019, ERE ka konfunduar aktet e miratuara nga vetë ajo, duke krijuar pasiguri juridike të marrëdhënies së palëve kontraktore. Në këto kushte kontrata e propozuar nga palët kontraktore për vitin 2019, do të duhet hynte në fuqi vetëm me përmbushjen në mënyrë kumulative të kushteve të vendosura në vendimin nr. 16, dt. 18.02.2019 të ERE.*
7. *Në lidhje me pikën 3 të vendimit nr. 167, dt. 04.11.2019 të ERE, ku parashikohet detyrimi i shoqërive KESH dhe OSHEE që për periudhën 01.01.2019-deri në hyrjen në fuqi të vendimit, të reflektojnë ndryshimet e devijimet midis programit dhe sasisë aktuale të livruar brenda muajit nëntor 2019, është një parashikim i cili bie ndesh me parashikimet e kontratës, pasi kontrata është konceptuar dhe miratuar të funksionojë mbi bazën e programeve/nominimeve, përveç kësaj palët gjatë kësaj kohe nuk kanë mundur të rakordojnë asnjëherë në lidhje me sasisë e programuara/nominuara dhe sasisë së livruar midis tyre.*

Konstatimet mbi pretendimet e shoqërisë OSHEE sh.a.

1. Në lidhje me pretendimin 1 sqarojmë se, sa parashtruar nga OSHEE sh.a. konstatojmë:
 - Kontrata e vitit 2018 e lënë në fuqi me vendimin nr.16/2019, e shtrin fuqinë juridike deri në miratimin e kontratës për vitin 2019 dhe jo deri në momentin e dakortësimit të kontratës për vitin 2019 nga palët.
 - Kontrata e vitit 2019 në një skenar në frymën e pretendimeve të shoqërisë OSHEE, do ta shtrinte fuqinë juridike që nga 04.11.2019, moment në të cilin është miratuar nga ERE e deri në 31.12.2019.
 - Palët gjatë seancave dëgjimore të organizuara në ERE kanë bërë me dije si të vetmin argument për të legjitimuar kërkesën për hyrjen në fuqi të kësaj kontrate në 01.03.2019, ndryshimin e administrimit të KESH sh.a., fakt që nga ERE është vlerësuar si argument jo bindës, duke qënë se kontrata lidhet mes shoqërive tregëtare dhe shpreh vullnetin e tyre pavarësisht ndryshimit të administratorit të shoqërive.
 - Siç sqaruar edhe në vendimmarrjen e ERE 167/2019, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë KESH sh.a. në zbatim të nenit 5 pika 2 të

VKM nr.244/2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, ka miratuar sasinë totale të energjisë së vitit 2019, me qëllim sigurimin e shërbimit të furnizimit për klientët fundorë nga shoqëria OSHEE sh.a., si dhe çdo parashikim në dispozitat e kontratës i referohet vlerës totale vjetore.

2. Në lidhje me pretendimin 2, ERE në pikën 1 gërma c të vendimit të bordit nr. 167/2019 është shprehur: *Neni 3, pika 7, bëhet: Vlera e kompesimit: Vlera që rezulton për sasinë e energjisë së paplotësuar nga shitësi me çmimin e përcaktuar sipas parashikimeve të nenit 5 të VKM nr. 244/2016 datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar.*

Sa më sipër, rezulton se ERE ashtu si edhe palët i referohen VKM nr.244/2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar. Ndryshimi sa më sipër në draft kontratën e dakortësuar mes palëve ka ardhur si rrjedhojë e historikut të keqintepretimit të kësaj dispozite, duke saktësuar se vlera kompensimi nga palët do të vlerësohet mbështetur në dispozitën e cituar të VKM nr.244/2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar.

3. Në lidhje me pretendimin 3 sqarojmë se VKM nr.244/2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, parashikon që Furnizuesi i Shërbimit Universal kompensohet nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike për sasinë e pasiguruar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike sipas vlerës së përcaktuar në kontratë. Ajo nuk shprehet për vlerën e negociuar mes palëve në kontratë.

Në të njëtin arsyetim, edhe vetë KESH në miratimin e planit të zhvillimit të shoqërisë, referuar sasisë në lekë, të parashikuar për kompensimin e sasisë së pasiguruar të energjisë për qëllime të kësaj kontrate, kalkulon sasinë e energjisë që parashikon të mos mbulojë dot, referuar të dhënave historike të kësaj shoqërie, me çmimin e përcaktuar në këtë kontratë e të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë, në masën 1.5 lekë.

Për saktësim, sipas programit ekonomik, kjo sasi përbëhet nga Totali prodhimit netto KESH për vitin 2019 në sasinë 3,805,935 MWh plus zërin kompensim të shprehur në vlerë lekë në masën 216,097 (000 lekë), e cila prodhon si rezultante në MWh (216,097/1.5 leke/KWh= 144,064 MWh).

4. Në lidhje me pretendimin 4 sqarojmë se :Duke vlerësuar se nuk është në kompetencën e ERE, të përcaktojë mënyrën sesi shoqëria do të menaxhojë derdhjen e të ardhurave për qëllime të kësaj kontrate, ajo që duam të theksojmë në lidhje me këtë pretendim është fakti që ERE nuk mundet të lejojë që, në kundërshtim me parashikimet e VKM nr.244/2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, shoqëria KESH sh.a. të derdhë në llogarine escrow çdo të ardhur që siguron si rezultat i shitjes së energjisë në treg të parregulluar duke qënë se të ardhura që KESH siguron, janë ato që gjenerohen nga kjo kontratë dhe shitja e energjisë në tregun e parregulluar.
- VKM nr.244.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, në nenin 4 pika 5.1 të saj parashikon se: *5.1 në çdo rast të vendosjes së detyrimit publik ndaj shoqërisë së prodhimit, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht apo pjesërisht nga shteti, Asambleja e Përgjithshme e kësaj shoqërie, pasi merr mendimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, vlerëson rast pas rasti mbi mënyrën e përdorimit të të ardhurave shtesë mbi ato të parashikuara në programin ekonomik, nëse do të shërbejnë si fond rezervë për balancimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë së prodhimit për periudhat e ardhshme, me qëllim minimizimin e riskut hidrologjik.*
- Autorizimi I KESH që për qëllime të kësaj kontrate të derdhte cdo të ardhur të krijuar nga shitja e energjisë në treg të parregulluar, në llogarinë escrow të krijuar për qëllime të kësaj kontrate, do të binte ndesh me sa parashikuar në këtë dispozitë të VKM nr.244/2016 e do të lejonte KESH sh.a. të shmangej nga detyrimi për të krijuar *fond rezervë për balancimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë së prodhimit për periudhat e ardhshme, me qëllim minimizimin e riskut hidrologjik.*
5. Në lidhje me pretendimin 5, sqarojmë që nëse ERE do të shprehej për pranimin e kërkesës së palëve që kompesimi i blerësit për sasinë e paplotësuar nga pala shitëse të bëhej me çmimin mesatar të shitjes së energjisë nga ana e shitësit në tregun e parregulluar, kjo do të binte ndesh me sa parashikuar në VKM nr.244/2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, e cila parashikon që Furnizuesi i Shërbimit Universal kompensohet nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike për sasinë e pasiguar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike sipas vlerës së përcaktuar në kontratë. Çmimi/vlera e përcaktuar dhe miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë KESH sh.a. për qëllime të kësaj kontrate është çmimi i shitjes së energjisë elektrike, nga KESH për OSHEE. Edhe në kuptim të vlerës së miratuar në planin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë KESH sh.a. për efekt të garantimit të kompensimit të sasisë së pasiguar për qëllime të kësaj kontrate është kalkuluar në raportin sasi e perealizuar me çmim I miratuar nga Asambleja në vlerën 1.5 lekë.

6. Në lidhje me pretendimin 6, sqarojmë se Kontrata e vitit 2018 e lënë në fuqi me vendimin nr.16/2019, e shtrin fuqinë juridike deri në miratimin e kontratës për vitin 2019 dhe jo deri në momentin e dakortësimit të kontratës për vitin 2019 nga palët
7. Në lidhje me pretendimin 7 sqarojmë se, është e paqartë se si palët duke qënë se janë rregulluar e lënë të operojnë me një kontratë të miratuar nga ERE, fuqia juridike e së cilës përfundon me miratimin e një kontrate të re për 2019, kanë gjykuar në diskrecionin e tyre, të operojnë jo në kushtet e ligjshmërisë së rregulluar me sa më sipër, e kanë vlerësuar që mundet të mos zbatojnë zbatojnë parashikimet e kësaj kontrate në çdo nen të saj, si për kompensimin ashtu edhe për rakordimin e sasive të livruara mbi bazën e faktit, por edhe përgjatë gjithë kohëzgjatjes së saj. Ndaj pretendimi i ngritur që palët kanë operuar në besimin se sa dakortësuar mes tyre por jo miratuar nga ERE, do të jetë doemos baza mbi të cilën do të funksionojë kjo marrëdhënie për periudhën e dakortësuar mes tyre, është i paqëndrueshëm. Konstatohet se :

- VKM 244/2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, në nenin 5 pika 3 sanksionon se : *Sasia e energjisë elektrike dhe çmimi i miratuar pasqyrohen nga palët në kontratën tip të miatuar nga ERE, sipas përcaktimeve të shkronjës “h” të nenit 20, të ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë elektrike”.*
- shkronja “h” e nenit 20, të ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë elektrike”, parashikon se *ERE miraton kontratat tip ose kushtet e përgjithshme të kontratave për shërbimet e rregulluara, të ofruara nga pjesëmarrësit e tregut, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.*

Sa më sipër, vendos ERE-n përpara detyrimit por edhe së drejtës si organi vendimmarrës në lidhje me konstatimin e ligjshmërisë dhe vlerësimin e parimeve të së drejtës të propozuara nga palët me qëllim rregullimin e kësaj marrëdhënie.

8. Përsa i përket pretendimit 8, që aktet e ERE-s kanë vendosur palët në kushtet e pasigurisë juridike: sqarojmë se rrethana e pasigurisë juridike lidhet thelbësisht me dy parime: mungesën e rregullimit nga organet shtetërore, mungesa e konstatimit të të cilit është evidente duke qënë se ERE ka rregulluar palët përgjatë 2018 dhe 2019 me një kontratë , dhe lidhet gjithashtu edhe me parashikime kundërshtuese sa i përket parimeve të së drejtës si dhe pandryshueshmërisë së ligjit për marrëdhëniet e rregulluara.

Për të kuptuar dhe zbatuar drejt këto parime, kërkohet, nga njëra anë, që ligji të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që palët t’i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji/rregullimi të mos qëndrojë statik nëse duhet. Pikërisht në këto rrethana ERE, si organi I vetëm I ngarkuar me ligj për të legjitimuar marrëdhënien e dy të ngarkuarve me detyrimin e shërbimit publik në kuptim të kësaj kontrate, ka marrë masat e duhura e të nevojshme që palët në çdo kohë të veprojnë në kushtet e një

marrëdhënie të rregulluar e të ligjshme, duke u kujdesur që në asnjë rast, vendimet e ERE të mos çënojnë të drejtat e garantuara nga ligji në fuqi për palët në marrëdhënie.

- Në konkluzion të sa më sipër por edhe në vijim të parashtrimeve të përfaqësuesve të shoqërive KESH sh.a dhe OSHE sh.a. në mbledhjen e bordit të ERE të datës 12.12.2019 nuk dokumentuan apo argumentuan mbështetjen në VKM nr. 244/2016, të ndryshuar, të ndryshimeve të draftit të kontratës së dakortësuar nga palët. Në thelb të këtyre argumentave, palët parashtruan dakortësinë mes tyre por nga ana tjetër VKM nr. 244/2016, i ndryshuar, qartësisht ka përckatuar disa nga elementët e marrëdhënies së furnizimit për qëllime të shërbimit publik nga KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a.
- Duke vlerësuar se asnjë nga argumentat e parashtruara nga ankimuesi KESH sh.a. nuk përbën provë të re, të tillë që të çojë bordin e ERE në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga ai nr.167/2019.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rrëzojë kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE nr. 167, datë 04.11.2019, "Mbi miratimin e draft kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 01.01.2019 -31.12.2019", si të pambështetur në prova të reja, të tilla që mund të çojnë bordin e ERE në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga vendimi Nr. 167, datë 04.11.2019.
2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë kërkuuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI